



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al
Tiranë 3/11/2025

Nr. K4/I68-2 Prot.
Nr. Dok. 202503389/2

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientet e Komisarariatit të Policisë Mat*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**

TIRANË

Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër

PESHKOPI

Shefit të Komisarariatit të Policisë Mat

BURREL

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisariatin e Policisë Mat më datë 1.09.2025.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu inspektimin në Komisariatin e Policisë Mat.

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Vullnet Topalli, me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.82/2024 "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1543, datë 19.11.2024, për miratimin e procedurës standarde "Ndalimi i përkohshëm policor" dhe Urdhrin

nr.1720, datë 20.11. 2023 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Mat z. Ervis Sançolli dhe me punonjësit e Komisarariatit të Policisë Mat, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, Shefi i Komisarariatit informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i punës vijoi takimin me punonjësin e dhomave të shoqërimit, dhe inspektoi ambientet e shoqërimit, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisaritati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se¹:

- Ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave për organizimin e trajnimeve me stafin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit, për plotësimin e regjistrat të të shoqëruarve që në momentin e hyrjes në komisarariat dhe sipas të gjitha rubrikave, dhe në veçanti të rubrikës për njoftimin e familjarëve me emrat, lidhjen familjare me të shoqëruarin dhe numrin e telefonave të tyre, sipas përcaktimeve në procedurën standarde

¹ Shkresa nr. K4/I63-2 prot., datë 24.10.2024, “Rekomandim për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Mat”.

dhe rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) për këtë qëllim.

- Ishte zbatuar rekomandimi, për dyllosjen e dhomave të sigurisë në këtë komisariat, sipas procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe nxjerrjen e akteve ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ndryshimin e këtyre ambienteve për hapësira të tjera të ndryshme në funksion të institucionit.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave nga Komisariati i Policisë së Mat për afishimin të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave për plotësimin me saktësi të regjistrit të të miturve në konflikt me ligjin si dhe evidentimi i të gjithë personave pjesëmarrës në çdo rast gjatë intervistimit të të miturve
- Ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e Komisarimit me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar.
- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, pasi ishin marrë masa për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare por për shkak të amortizimit të godinës nuk është realizuar eliminimi i lagështirës në të gjitha ambientet e këtij komisariati.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarimin e Policisë Mat, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur,

femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe ndërtimin e godinës së re të Komisarariatit të Policisë Mat në përputhje me procedurën standard “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mat.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm, ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion dhe për ndërprerjen e praktikës së marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës.²
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të ngrohjes në ambientin e shoqërimit, për shkak të kushteve të rënduara atmosferike të kësaj zone.

Në përfundim të inspektimit, pavarësisht disa masave që ishin marrë për respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, në Komisariatin e Policisë Mat vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, që i gjeni si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mat, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “*Për Policinë e Shtetit*” dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit³.

Grupi i inspektimit konstatoi se ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit dhe përbëhej nga 1 (një) dhomë e cila përdorej vetëm për

² Kreu VII, pika 4/d e Procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”.

³ Kreu VI, pika 4/b e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

personat e rritur. Ndërsa personat e shoqëruar gra dhe të mitur në konflikt me ligjin, sipas informacionit, mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë.

Dhoma e shoqërimit ishte me sipërfaqe të bollshme dhe me kapacitet deri 3 persona. Dritarja e dhomës ishte me përmasa të tilla që lejonte hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale dhe kishte të vendosur një skarë hekuri me shufra vertikale dhe horizontale. Ajo ishte e lyer dhe e pastër nga ana higjieno-sanitare.

Dhoma e shoqërimit ishte e pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar⁴. Dera e dhomës së shoqërimit mbyllej me çelës dhe kishte bravë të rregullt.

Në këtë ambient, ishte mbyllur tualeti në korridorin e dhomës së shoqërimit për shkak të daljes nga funksioni dhe amortizimit ndër vite, dhe personat e shoqëruar përdornin tualetin e administratës i cili ndodhej në katin e dytë të Komisariatit. Sipas procedurës standarde *“Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m². Tualetet mund të ndërtohen brenda dhomës së shoqërimit (pa cenuar sipërfaqen e dhomës së shoqërimit) ose më vete në korridor dhe pranë dhomave të shoqërimit.”*⁵.

Në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

Në Komisarlatin e Policisë Mat, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që u bë zyrove të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, provat materiale të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera ishin të paketuara dhe të emërtuara⁶.

⁴ Kreu VI, pika 4/f e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

⁵ Kreu VI, pika 4/e e.2 procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

⁶ Neni 215 i K.Pr.P. ka parashikuar shprehimisht:

Vulosja e sendeve të sekuestruara (Shtuar pika 4, 5 dhe 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

“1. Sendet e sekuestruara sigurohen me vulën e organit procedues ose, në varësi nga natyra e sendeve, me mjete të tjera të përshtatshme që tregojnë se ato ruhen për nevojat e drejtësisë. Krijimi i dhomave të

Në mjediset e komisariatit nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.

Në dhomën e shoqërimit mungonte sistemi ngrohje/ftohje, i cili e përkeqësonte trajtimin e të shoqëruarve kryesisht në periudhën e dimrit.

Në kohën e inspektimit, nuk kishte persona të shoqëruar në ambientet e këtij komisariati. Ndërsa për periudhën janar – shtator 2025 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 148 persona të shoqëruar, nga të cilët 133 persona të rritur nga të cilët 4 gra dhe 11 persona të mitur në konflikt me ligjin.

Gjithashtu, përgjatë inspektimit punonjësit e policisë na informuan se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore procedurale që ata kanë, gjithashtu në zyrën e specialistit të pritjes gjendeshin të printuara kartat e të drejtave për t'u pajisur personat e shoqëruar e për t'u njohur me të drejtat e tyre në orët e para të shoqërimit në ambientet e komisariatit të policisë. Mekanizmi Kombëtar ka kërkuar prej vitesh dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarariat. Ky qëndrim u mbështet edhe nga KPT në vizitën e tyre.⁷

Gjatë inspektimit u konstatua se, brenda në dhomën e shoqërimit, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë, si dhe të personave të ndaluar/arrestuar edhe në gjuhë të huaj.

Nga inspektimi, u evidentua se gjendja teknike e godinës së komisariatit vazhdonte të ishte e njëjtë me vitin e kaluar dhe se amortizimi e bënte edhe më të nevojshme ndërhyrjen sa më të shpejtë për kryerjen e rikonstruksionit tërësor të saj.

Ambientet e sigurisë, kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve

depozitimit të provave materiale është masë parandaluese e cila shmanë aktet e mundshme të dhunës psikologjike/fizike që mund të kryhen nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të personave.

2. Organi procedues nxjerr kopje të dokumenteve dhe fotografi ose riprodhime të tjera të sendeve të sekuestruara që mund të ndryshojnë ose që ruhen me vështirësi, të cilat i bashkon me aktet dhe urdhëron ruajtjen e tyre në sekretari.”

⁷ CPT u bënë thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).

Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohej të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

Grupi i inspektimit konstatoi se ambientet e sigurisë nuk ishin funksionale në këtë komisarariat. Ato janë dyllosur dhe nuk përdoren. Personat e arrestuar/ndaluar në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

“Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, në Komisariatin e Policisë Mat, ishte sipas “Model nr.1”, të përcaktuar në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 894 dt. 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 5 orë në raste të veçanta, por mesatarisht ata mbaheshin për veprime rreth 4 orë. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit.

Nga inspektimi u konstatua se Komisarati i Policisë Mat, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisariateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin⁸.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat ishte hapur regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24, “*Trajtimi i ankesave ndaj veprimeve policore*” të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”. Regjistrat ishin të sekretuar.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë Mat, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin marrjen në pyetje të personave

⁸ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

të shoqëruar nga punonjësit e policisë. Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁹: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare. KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e punonjësve të policisë së shtetit, ashtu dhe nga vetë të shoqëruarit, ndaluarit e të arrestuarit.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde¹⁰. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

⁹ electronic recording of police interviews, fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

¹⁰ Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat kryesisht.

Përgjatë inspektimit në Komisaratin e Policisë Mat, u konstatua se kishte një listë të afishuar në ambientet e komisaritit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht. Kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023. KPT-ja bën rekomandime për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohet gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”*¹¹.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Prania e psikologut në këtë Komisarati, sigurohej pjesërisht nga Urdhri i Psikologut, bazuar në shkresën nr. 4 prot., datë 08.01.2024, pasi nga lista e psikologëve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerit të policisë në Mat, vetëm një nga gjashtë psikologët i përgjigjej nevojave të Komisaritit. Për këtë arsye, Komisarati Mat asistohet si nga psikologu i Bashkisë Mat ashtu dhe psikologun e shkollës së mesme Mat kur kishte ngjarje me nxënës të saj.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Qendrën Shëndetësore Mat.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar*

¹¹ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për sigurimin e fondeve buxhetore, për rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisaritit të Policisë Mat, në përputhje me procedurën standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* me qëllim krijimin e kushteve për trajtimin dinjitoz të personave të shoqëruar, por edhe të kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit e policisë së këtij Komisariati.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mat, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mat.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm, ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës¹².
5. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të ngrohjes në ambientin e shoqërimit, për shkak të kushteve të rënduara atmosferike të kësaj zone.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në të gjitha ambientet e këtij komisariati.

¹² Kreu VII, pika 4/d e Procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*.

8. Marrjen e masave për rikonstruksimin e tualeteve dhe vënien e tyre në funksion sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

**i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI**

d.v